




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. D. o. Dep.	20
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	03
Nr. Prot Br Prot Prot No	01-4003/18
Data Datum Date	22-18-2018
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.11.2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

***I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-1487/18 për zyrtarin e lartë z. Demë Çeta, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Istogut, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit Publik.***

***II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.***

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-1487/18, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Demë Çeta, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Istogut.

Inicimi i këtij rasti është bërë pas dyshimit për situatë të konfliktit të interesit, apo papajtueshmërisë, për zyrtarin e lartë z. Demë Çeta, i cili gjatë ushtrimit të funksionit publik si Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Istogut ushtron edhe funksionin si anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike "Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë-Sh.A.

Agjencia kundër Korrupsionit lidhur me këtë rast ka zhvilluar procedurën e paraparë për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, sipas procedurës zyrtarit të lartë z. Demë Çeta, i kemi dërguar shkresë njoftuese ku e kemi njoftuar për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik, pas kësaj shkrese z. Demë Çeta ka shprehur interesim për tu informuar me gjerësisht lidhur me rastin e iniciuar për të.

Ne kuadër të procedurës së paraparë është organizuar takim informues me zyrtarin z. Demë Çeta, gjatë takimit zyrtari kompetent nga Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar me situatën për të cilën është iniciuar procedura ndaj tij.

Gjatë këtij takim zyrtari i lartë z. Demë Çeta, ka deklaruar se është i angazhuar si anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike “Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë, Sh. A. e cila ndërmarrje nuk i përket komunës së Istogut pasi që kjo ndërmarrje është në pronësi të Qeveris së Kosovës. Lidhur me angazhimin e tij si anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike “Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë, Sh. A. nuk ka njohuri se mund të ketë ndonjë ndalës në ushtrim të funksionit publik por me gjithë atë është i vetëdijshëm se nëse kjo situatë paraqet papajtueshmëri ose konflikt të interesit pas konstatimit të AKK-së është i gatshëm që ta respektoj çdo vendim të AKK-së.

Agjencia Kundër Korrupsionit ka analizuar të gjitha informacionet që ka pas ne dispozicion, duke vlerësuar, Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Statutin e ndërmarrjes Publike “Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë, Sh. A, dhe siç shihet ndërmarrja publike “Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë, Sh. A, sipas Listës 1 të nenit 23 i Ligjit Për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, e rendit këtë ndërmarrje si Ndërmarrje Publike Qendrore që janë në pronësi të Qeveris së Republikës së Kosovës ( neni 3 pika 3.2 ).

Andaj bazuar në gjendjen faktike lidhur me rastin si dhe pas vlerësimit të informacioneve në dispozicion lidhur me këtë rast kemi ardhur në përfundim dhe mund të konstatojmë se: nuk ka prova të mjaftueshme që e dëshmojnë situatën e konfliktit faktik të interesit në ushtrim të funksionit publik, për zyrtarin e lartë z. Demë Çeta, Drejtor i Drejtorisë të Inspeksionit në Komunën e Istogut, mirëpo në këtë rast kemi një ndalesë të paraparë me nenin 13 pika 2 të ligjit nr.06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrim të Funksionit Publik, ku thuhet se zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj.

Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.

Gjatë ushtrimit të funksionit publik nëse eventualisht mund të paraqitet ndonjë konflikt i interesit “rast për rast” zyrtari duhet të veproj sipas nenit 17 të Ligjit nr.6/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në të cilin shprehimisht thuhet:

1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.
4. Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, institucioni punëdhënës regjistron identitetin e zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interesi dhe konfliktin apo papajtueshmërinë e konstatuar, palët e interesuara, burimin e informatave, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

5. Deklaratat për interesat private dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë konsiderohen dokumente zyrtare.

Duke marr për bazë të gjitha këto u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Shaip Havolli /

---

Agjencia Kundër Korrupsionit / Agencia protiv korupcije / Anti Corruption Agency

[www.akk-rks.org](http://www.akk-rks.org) ,